

Shtojca 1

e

**Urdhrit për caktimin e datës për mbajtjen e konferencës mbi ecurinë e çështjes
dhe për paraqitjen e parashtrimeve**

Publike

Rendi i ditës për konferencën mbi ecurinë e çështjes dhe/ose për parashtrime me shkrim

Informacionet që duhen nxjerrë nga Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) dhe nga Mbrojtja e secilit të akuzuar (bashkërisht të quajtur “Mbrojtja”), sipas rastit:

1. Pyetje të përgjithshme:

- a) A është ZPS-ja ende duke kryer hetimin e kësaj çështjeje, e nëse po, a do të ketë ndikim dhe si do të ndikojë kjo në zhvillimin e përshpejtuar të procesit;
- b) Cila është sasia e provave që zotëron aktualisht ZPS-ja dhe që synon të përdorë për këtë proces;
- c) Në sa dëshmitarë është mbështetur ZPS-ja për Aktakuzën e Konfirmuar dhe a synon të mbështetet në këta dëshmitarë gjatë gjykimit; dhe sa dëshmitarë synon të shtojë ZPS-ja në listën e dëshmitarëve për qëllimet e gjykimit;
- d) Në rast se Mbrojtja dëshiron të parashtojë: në këtë fazë dhe pa cenuar të drejtat e të akuzuarve sipas Ligjit, nëse Mbrojtja parashikon të hetojë dhe afërsisht sa kohë do t’i duhet për t’i mbyllur veprimtaritë hetimore; dhe
- e) Në rast se Mbrojtja dëshiron të parashtojë: në këtë fazë dhe pa cenuar të drejtat e të akuzuarve sipas Ligjit, nëse Mbrojtja mund të bëjë të ditur nëse do të japë njoftim për alibi apo arsye të tjera për përjashtim nga përgjegjësia penale.

2. Materialet e rregullës 102(1)(a) (Materialet mbështetëse të Aktakuzës)

- a) Sasia e gjithsejtë e materialeve të tilla, përfshirë edhe një detajim të sasisë (numri i deklaratave të dëshmitarëve, deklaratave të marra prej të akuzuarve, transkripteve, raporteve, dokumenteve të tjera, materialeve audio/video, fotografive, sendeve), përfshirë numrin e gjithsejtë të faqeve dhe gjatësinë e materialeve audio/video, sipas rastit;

- b) Nëse janë finalizuar përkthimet në gjuhën shqipe të deklaratave të dëshmitarëve që synon të thërrasë ZPS-ja për të dëshmuar në gjyq ose, në rast se janë ende duke u përkthyer, kur pritet të përfundohen këto përkthime;
- c) Nëse kanë nevojë për redaktim materialet e rregullës 102(1)(a) dhe versionet e ndryshme të përmbledhjes së detajuar, përfshirë edhe plotësimet e saj. dhe
- d) Nëse do të ishte e gatshme ZPS-ja t'i bënte të njohura Mbrojtjes pjesë të materialeve që janë objekt i kësaj dispozite përpara afatit 30-ditor të parashikuar në rregullën 102(1)(a) të Rregullores.

3. Materialet e rregullës 102(1)(b) (Materialet shtesë për t'u përdorur në gjykim)

- a) Informacion nëse ZPS-ja synon të nxjerrë, krahas materialeve që janë objekt i rregullës 102(1)(a) të Rregullores, edhe materiale që janë objekt i rregullës 102(1)(b) të Rregullores, përfshirë:
 - deklaratatë të dëshmitarëve që synon të thërrasë ZPS-ja të dëshmojnë në gjykim, gjithashtu nëse janë finalizuar përkthimet e tyre në gjuhën shqipe, ose në rast se janë ende duke u përkthyer, kur pritet të përfundohen këto përkthime;
 - deklaratatë të tjera të dëshmitarëve, aktekspertiza, deponime ose transkripte të cilat ZPS-ja synon t'i paraqesë në gjykim; dhe
 - prova materiale që ZPS-ja synon t'i paraqesë në gjykim.
- b) Në rast se ZPS-ja synon të nxjerrë materiale të tilla, një vlerësim të sasisë së tyre dhe informacion për llojin e tyre, përfshirë numrin e faqeve dhe gjatësinë e materialeve audio/video, sipas rastit;

- c) Nëse materialet e rregullës 102(1)(b), do të kenë nevojë për redaktim; dhe
- d) Kur do të ishte e gatshme ZPS-ja t'ia bënte të njohura Mbrojtjes materialet që janë objekt i kësaj dispozite.

4. Materialet e rregullës 102(3) (Materiale provash për përgatitjen e Mbrojtjes, që i janë marrë të akuzuarit apo që i përkasin atij)

- a) Informacion nëse ZPS-ja synon t'i bëjë të njohura Mbrojtjes materiale nën ruajtjen ose kontrollin e saj që janë objekt i rregullës 102(3) të Rregullores, përfshirë çfarëdo deklarate, dokumenti, fotografie apo çdo sendi tjetër të prekshëm, që Mbrojtja i konsideron juridikisht thelbësore për përgatitjen e vet, ose që i janë marrë apo i kanë përkitur të akuzuarit;
- b) Në rast se ZPS-ja ka materiale të tilla nën ruajtje apo në kontroll, një vlerësim të sasisë së tyre dhe informacion për llojin e tyre, përfshirë numrin e faqeve dhe gjatësinë e materialeve audio/video, sipas rastit;
- c) Nëse materialet e rregullës 102(3), do të kenë nevojë për redaktim; dhe
- d) Kur do të ishte e gatshme ZPS-ja t'i jepte njoftim të hollësishëm Mbrojtjes për materiale të tilla.

5. Materialet e rregullës 103 (Provat shfajësuese)

- a) Një informacion për sasinë dhe llojin e materialeve shfajësuese sipas kuptimit të rregullës 103 të Rregullores, që ka nën ruajtje, kontroll apo për të cilat ka dijeni faktike deri tani ZPS-ja dhe një detajim të sasisë të tyre (numri i deklaratave të dëshmitarëve, transkripteve, raporteve, dokumenteve të tjera, materialeve audio/video, sendeve), përfshirë numrin e gjithsejtë të faqeve dhe gjatësinë e materialeve audio/video, sipas rastit; dhe

- b) Në rast se ZPS-ja zotëron materiale të tilla, nëse do të jetë nevoja për redaktime menjëherë para nxjerrjes së tyre.

6. Materialet e rregullës 107 (Materialet e mbrojtura)

- a) Informacion nëse ZPS-ja ka nën ruajtje apo në kontroll materiale që synon t'i paraqesë si prova, të cilat janë siguruar në mënyrë konfidenciale dhe vetëm për marrjen e provave të reja, përfshirë edhe një vlerësim të sasisë dhe një informacion për llojin e tyre, përfshirë numrin e faqeve dhe gjatësinë e materialeve audio/video, sipas rastit;
- b) Në rast se ZPS-ja synon t'i nxjerrë këto materiale, informacion nëse materialet janë objekt i rregullës 102(2) dhe/ose i rregullës 103 të Rregullores;
- c) Informacion nëse dhe për cilat materiale ZPS-ja synon të marrë pëlqimin e dhënësve të informacioneve dhe kur mund të pritët marrja e këtij pëlqimi; nëse ZPS-ja ka bërë hapa për marrjen e pëlqimit të dhënësve të informacioneve për nxjerrjen e këtyre materialeve ose nëse hapa të tillë parashikohen në të ardhmen e afërt;
- d) Informacion nëse ZPS-ja synon t'i bëjë kërkesë Gjykatësit të Procedurës Paraprake për t'u liruar tërësisht ose pjesërisht nga detyrimi i rregullës 102 dhe/ose i rregullës 103 të Rregullores për nxjerrjen e materialeve fillestare;
- e) Në rast të nxjerrjes së materialeve të tilla, informacion nëse do të jetë nevoja për redaktime; dhe
- f) Nëse materiale të tilla nuk mund të nxirren, informacion nëse do të kërkohen masa kompensuese sipas rregullës 108(2) të Rregullores, përfshirë edhe llojin e materialeve që mund të preken nga kjo.

7. Procedura e nxjerrjes së materialeve

- a) A munden palët të dorëzojnë, së bashku me çdo paketë të materialeve të nxjerra, një tabelë ku informacioni të kategorizohet sipas akuzave të Aktakuzës së Konfirmuar, duke iu referuar veprave penale që përbëjnë bazën e tyre, elementëve kontekstualë të veprave penale, veprimeve të pretenduara të të akuzuarit ose, sipas rastit, provave që do të paraqiten nga Prokurori i Specializuar;
- b) A munden palët të propozojnë një tabelë standarde (që përmbush kërkesat e rregullës 109(c) të Rregullores) për diskutim në konferencën për ecurinë e çështjes;
- c) Nëse kjo nuk është e realizueshme, çfarë propozimi alternativ kanë palët, i cili gjithsesi do ta përmbushte kushtin e relevancës dhe shkallën e saktësisë së parashikuar në rregullën 109(c) të Rregullores dhe që do t'u ofronte palëve dhe Gjykatësit të Procedurës Paraprake një orientim të njëmendtë; dhe
- d) A pajtohet Mbrojtja që t'i jepet një tabelë përmbledhëse në momentin kur dorëzohet dosja paraprake e ZPS-së; po kështu, a pajtohet ZPS-ja që t'i jepet një tabelë përmbledhëse në momentin kur dorëzohet dosja paraprake e Mbrojtjes.